



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Ref. Nr. 01/04
Datë: 08.02.2023

Mbështetur në nenet 92 paragrafi 92.4 dhe 93 paragrafi 93.4 të Kushtetutës së Kosovës së Republikës së Kosovës, neni 10 dhe 11 i Ligjit Nr.06/L-113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nenin 15 të Ligjit Nr.08/L-018 Për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme, nenit 4 paragrafi 1.1 dhe 1.2. të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse, nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, i Rregullores (QRK)Nr.02/2021 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nxjerr:

V E N D I M

1.Vendoset rregullimi i çmimeve dhe caktohen masat e tjera mbrojtëse për produktet e naftës të përdorshme në transport si vijon:

- 1.1. Marzha Tregtare maksimale e lejuar e shitjes me shumicë është dy (2) eurocentë për litër;
- 1.2. Marzha Tregtare maksimale e lejuar e shitjes me pakicë është dymbëdhjetë (12) eurocentë për litër;
- 1.3.Detyrohen subjektet për të furnizuar dhe për t'i ofruar për shitje produkte të naftës, si para vendosjes së çmimeve dhe masave mbrojtëse.
- 1.4.Mbikëqyrja e shtuar inspektuese;
- 1.5.Paraqitja e përshpejtuar e rastit te Autoriteti i Konkurrencës, kur ka dyshime për cenimin e konkurrencës së lirë.

2.Rregullimi i çmimeve dhe masat nga neni 1 i këtij Vendimi, mbeten në fuqi tridhjetë (30) ditë, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

3. Detyrohet Inspektorati i Tregut , Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës, dhe organet e tjera përgjegjëse të zbatojnë këtë Vendim.

Arsyetim

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka monitoruar rregullisht tregjet e produkteve të naftës dhe bazuar në evidencën ditore të pranuar nga Dogana e Kosovës lidhur me çmimet e furnizimit/importit të produkteve të naftës si dhe raportin e Inspektoratit të Tregut të pranuar me datë 08.02.2023, lidhur me çmimet e shitjes me pakicë të produkteve të naftës, është evidentuar mospërshtatje e çmimeve vendore me lëvizje të mëdha të çmimeve në tregun botëror, çka përbën bazë/shkas për rregullimin e çmimeve dhe caktimin e masave të tjera mbrojtëse sipas nenit 15 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Ligjit Nr.08/L-018 Për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, nenit 3 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse.

Rregullimi i çmimeve dhe masave tjera mbrojtëse, caktohen në bazë të nenit 4 dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse dhe ka për qëllim mbrojtjen e konsumatorit, për të mbrojtur konkurrencën dhe për të menjuar çrregullimet në treg.

Llogaritja e marzhës tregtare maksimale e lejuar për shitje me shumicë dhe pakicë bëhet sipas nenit 4 paragrafi 1.1 dhe 1.2. të U/A Nr. 03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse.

Ky Vendim hynë në fuqi një (1) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar në atë që u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Rozeta HAJDARI



Ministre



Vendim i dërgohet:

- Kabinetit të Zyrës së Kryeministrit;
- Kabinetit të Ministres;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Doganës së Kosoës;
- Inspektoratit të Tregut;
- Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit.